



Rruga “Nikolla Tupe”, Nr. 1, Kati 3
Tiranë, Shqipëri
NIPT: K52311009R
+355 69 60 60 058
www.credinsinvest.com

Raport Mjor për fondin Credins Dynamic

Portofoli i Fondit Credins DYNAMIC, në përputhje me Politikën e Investimit, do të përbëhet kryesisht nga obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë ose vendeve të Bashkimit Europian të denominuara në monedhën Euro, si dhe kuota të fondeve të investimeve (SIK/ETF).

Data e raportit: 31.10.2025

Informacion për Fondin

Shoqëria Administruese e Fondit:	Credins Invest
Data e lançimit të fondit:	15 shtator 2025
Periudha e akumulimit	15 shtator – 15 tetor 2025
Monedha e Fondit:	Euro

Fondi i adresohet investitorëve që kërkojnë:

- ✓ një normë kthimi më të lartë se produktet bankare në Euro,
- ✓ likuiditetin që i mungon këtyre produkteve.

Profil i rrezikut dhe përfitimit

Ecuria e normës së kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit obligacioneve dhe të cmimit kuotave të fondeve të investimit ku investon Fondi.

Rrezik i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë

Përfitimet tipike më të larta

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

Fondi CREDINS DYNAMIC ka një profil rreziku në nivelin 3, pra të mesëm.

Të dhëna kryesore për Fondin

Vlera Neto e Aseteve	7,960.90 Euro
Çmimi i kuotës	100.0113 Euro
Kthimi nga investimi (15.10.2025 - 31.10.2025)	0.01%

Karakteristikat e rrezikut të aseteve në Fond

Depozitat Bankare

Depozita Bankare si klasë asetë përmban rrezikun e kredisë së bankës dhe rrezikun e rikimit në momentin e maturimit të saj. Rreziku i rikimit nënkupton uljen e normës së interesit kur depozita rivendoset me të njëjtin maturitet.

Obligacionet qeveritare

Këto asete janë të emetuara nga shteti shqiptar në monedhën Euro, ose janë të emetuar ose të garantuara nga autoritete qendrore, rajonale ose vendore të BE-së, ose nga çdo shtet i miratuar nga AMF në monedhën Euro të tregtuara në tregje të rregulluara ndërkombëtare. Obligacionet qeveritare janë subjekt i rrezikut nga normat e interesit dhe kanë nota krediti (“rating”) të ndryshme.

Obligacionet Korporative

Obligacionet korporative janë tituj borxhi të emetuara nga shoqëri private në monedhën Euro. Këto instrumente përmbajnë riskun e kredisë që mbart shoqëria që emeton. Këto tituj borxhi vlerësohen me risk më të lartë kredie se titujt e borxhit qeveritare. Këto tituj borxhi ekspozohen ndaj riskut të normave të interesit dhe mbartin një risk të lartë likuiditeti. Fondi investon në tituj korporativ vetëm të tregtuar në tregje të rregulluara ose në bursë titujsh, në Republikën e Shqipërisë ose në një shtet të BE-së, apo në shtete të miratuar nga AMF.

Kuota të fondeve të investimeve (SIK/ETF)

Kuota të fondeve të investimeve (SIK) ose të fondeve të investimeve të tregtuara në bursë (ETF) janë kuota fondesh të cilat i përmbahen një politike investimi dhe riskut të përcaktuar. Këto instrumente ekspozohen nga risku i luhatshmerisë të cmimit dhe mbartin riskun e totalit të instrumenteve që formojnë portofolin e këtyre fondeve.

Fondi nuk investon më shumë se 10% të vlerës së sipërmarrjes në aksione apo kuota të një sipërmarrjeje të vetme, me kusht që tërësia e ekspozimeve të mos tejkalojë 30% nëse këto sipërmarrje nuk janë klasifikuar SIKTT apo UCITS në vendet e BE-së.

*Për më tepër informacion rreth rrezeve të Fondit, ju lutem referojuni seksionit përkatës në Prospektin e Fondit Credins Dynamic.

Kostot dhe Tarifet

Tarifat përdoren për të paguar kostot e administrimit të Fondit, duke përfshirë tarifën e administrimit të Shoqërisë Administruese, tarifën e depozitarit, tarifën e AMF, kostot e auditimit vjetor të Fondit, kostot e transaksioneve, etj, si në tabelën e mëposhtme. Tarifa e kostos së administrimit dhe të gjitha kostot e tjera të listuara në një vit kontabël nuk do të tejkalojnë në asnjë rast maksimumin prej 3.5% të vlerës neto të aseteve të fondit.

Tarifa e hyrjes apo daljes	0%
Tarifa e administrimit	1.5% në vit e VNA të Fondit
Komisione/tarifa nga shlyerja e kuotave	Tërheqje brenda vitit të parë: 1.5% e vlerës së tërhequr Pas vitit të parë: Nuk ka tarifë dalëse
Kosto të transaksioneve për investimin e aseteve të fondit	Sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese
Tarifa të tjera të vazhdueshme	Referojuni prospektit të fondit
Tarifa e AMF	0.05% në vit e VNA